



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë periudhës 24-30 mars janë mbajtur seminari i 5 dhe i 6 për 17 grupet që janë duke u trajnuar në kuadër të programit të MKLSH. Meqenëse shumë mësime të përfshirë në trajnim vijojnë Fakultetin e Edukimit dhe po mungojnë të shtunave, atëherë është vendosur që 2 seminarët të mbahen gjatë pushimit pranveror, në mënyrë që mësime të përfshirë t'iu mundësohet vijueshmëria e rregullt. Në fund të seminarit të 6 mësime të përfshirë janë njoftuar se gjatë muajit prill do të organizohet monitorimi i dytë për të gjithë pjesëmarrësit në trajnim. Tri grupe që janë duke u trajnuar në Skenderaj, Kaçanik dhe Vushtri kanë realizuar vetëm seminarin e 5, ndërsa seminarin e 6 do ta mbajnë në fillim të prillit. Këto grupe kanë mundësi të organizojnë trajnimet gjatë muajit prill, për arsye se nuk ka pjesëmarrës që vijojnë fakultetin pa shkëputje nga puna.



■ Më 25-26 mars 2007 është mbajtur Seminari i Shkrimit dhe Leximit

për 10 grupe që janë përfshirë në trajnim në kuadër të programit të MKLSH-së. Trajnimi i këtyre grupeve mundësohet nga KEC. Nga skedat e daljes shihet se mësime të përfshirë janë shumë të kënaqur nga seminari, përgatitja e trajnerëve dhe doracakët, të cilët i marrin me rastin e përfundimit të seminarit. Pyetja më e shpeshtë e pjesëmarrësve në trajnim është: kur do të fillojnë grupet tjera për të njoftuar kolegët e tyre, të cilët janë shumë të interesuar të përfshihen në trajnim në kuadër të MKLSH-së. Në fund të seminarëve mësime të përfshirë janë njoftuar se gjatë muajit prill ata do të monitorohen nga trajnerët në klasat e tyre.

■ Po ashtu më 24-25 mars është mbajtur dhe seminari i 5 i MKLSH-së në Istog. Në këtë grup janë përfshirë mësime të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut. Seminari është zhvilluar sipas agjendës së paraparë dhe çdo gjë ka shkuar sipas planit.

Hap pas Hapi

■ Me datat 8-9 dhe 15-17 mars u mbajt trajnimi fillestar për klasën e parë në Ferizaj. Në trajnim morën pjesë 35 pjesëmarrës. Për këta pjesëmarrës është paraparë trajnimi avancues për klasën e parë që do të mbahet në qershor.



■ Janë duke vazhduar monitorimet e mësimdhënësve të cilët punojnë me metodologjinë Hap pas hapi. Këto monitorime bëhen me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës. Monitorimet u organizuan si në shkolla fillore ashtu edhe në Institucione parashkollore.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Cikli i dytë i trajnimeve të 500 mësimdhënësve në kuadër të Projektit “Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim” në të cilin marrin pjesë mësimdhënës nga shkollat e rajonit të: Prishtinës, Ferizajt, Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Mitrovicës dhe Gjilanit është duke vazhduar edhe gjatë muajit mars. Trajnimet janë duke u mbajtur me sukses dhe vlerësimet e pjesëmarrësve janë shumë pozitive.

■ Është përfunduar drafti i parë i dy politikave, ku njëra ka të bëjë me format alternative në edukimin para-shkollor dhe tjetra me parandalimin e braktisjes së shkollimit. Në hartimin e politikës së dytë janë përfshirë edhe pjesëmarrës nga MASHT-i dhe nga CRS.



■ Në Gjakovë u mbajt punëtorja tre ditore për hartimin strategjisë së veprimit të përbashkët të organizatave partnere në këtë Projekt (KEC, SBASHK dhe KAHCR). Në punëtori morën pjesë përfaqësues të tri organizatave. Mbetet që të shkruhet strategjia kornizat e të cilës u përcaktuan gjatë kësaj punëtorie.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Në kuadër të projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II, shkollat pjesëmarrëse në ciklin e parë të këtij projekti kanë vazhduar hartimin e projekteve shkollore. Bashkëpunëtorët profesionalë të terrenit gjatë gjithë kohës kanë ndihmuar shkollat në procesin e planifikimit. Pas përfundimit të planifikimeve në nivel të shkollave, projekt-propozimet janë vlerësuar në nivel komunal nga Ekipet Komunale për Grante Shkollore. Ndërsa dokumentacioni i kompletuar i projekteve shkollore, së bashku me vlerësimet e Ekipeve komunale për Grante Shkollore, janë dërguar te Ekipi koordinues i Projektit, i cili do të ftojë takimin e Këshillit për Arovimin e Granteve Shkollore. Ky këshill do të vlerësojë projekt-propozimet e shkollave në nivel qendror.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Gjatë muajit mars, është përgatitur logjistika e projektit, përkatësisht janë definuar nevojat për implementim të mëtutjeshëm.

Përgatitjet për modulën e dytë të trajnimit “Edukimi për të Drejtën Shoqërore”, janë në përfundim e sipër. Ky modul, do të

mbahet gjatë muajit prill, respektivisht më datat 15-17. Pas përfundimit të këtij Moduli, pjesëmarrësit do të pajisen edhe me certifikatat për pjesëmarrjen në këtë trajnim.

Access Microscholarship Program

■ Në muajin mars, mësimi është zhvilluar sipas dinamikës së projektit. Edhe pse gjatë këtij muaji kemi pasur vështirësi me nxënësit të cilët vijnë nga Graçanica. Duke pasur parasysh situatën politike të zhvilluar kohëve të fundit në Kosovë, nxënësit e komunitetit serb nuk janë ndier aq të sigurt që të vazhdojnë me mësimin e gjuhës angleze së bashku me nxënësit shqiptarë. Andaj, duke pasur parasysh këto gjëra, nxënësit e komunitetit serb kanë vendosur që të vijnë së bashku në një grup, gjë që pak ka vështirësuar procesin mësimor. Sidoqoftë, mësimi vazhdon të mbahet dhe besojmë se do të vazhdojë në këtë mënyre deri në fund të programit.

■ Grupi nga Prizreni, kanë vazhduar mësimin dhe nuk ka pasur ndonjë vështirësi. Po ashtu, planifikohet që gjatë muajit prill, nxënësit të kenë edhe një aktivitet social. Ky aktivitet mendohet të bëhet me të tri grupet së bashku.



■ Në Prizren është mbajtur aktiviteti social me fëmijët pjesëmarrës në programin Access. Janë zhvilluar vizita në të gjitha radio-stacionet e Prizrenit. Fëmijët kanë pasur rastin të njoftohen me ecurinë e punës nëpër radio-stacione. Vizitat janë bërë në radio-stacionet që menaxhohen nga komunitetet e ndryshme etnike, si Radio Romano Avazo (radio në gjuhën rome), Radio Omega 3 (radio në gjuhën boshnjake), në radio Yeni Dynem (radio në gjuhën turke) Radio-Prizren etj.

Përgatiti: Petrit Tahiri